



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 254 prot

Tiranë, më 27.05 2025

VENDIM

Nr. 3 datë 27.05 2025

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 8/5/2025

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 8.5.2025 vendosi:

1. Për projektudhëzimin “Për përcaktimin e rregullave, kritereve dhe dokumentacionit për identifikimin e zonave me prioritet zhvillimi në territoret e bashkive” propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në mbledhjen e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Termi “zonë malore” nuk përputhet me termin “zonë zhvillimi”. Ligji përdor qartë termin “zonë malore me përparësi zhvillimi”, ndërkohë që udhëzimi referon vazhdimisht termin “zonë zhvillimi”;

- Neni 4 i ligjit i jep Ministrit Përgjegjës për Pushtetin Vendor të drejtën për të propozuar shpalljen e zonës, me kërkesë të bashkisë, ndërkohë udhëzimi (pika II.9) përfshin një vendim të Këshillit Bashkiak përpara paraqitjes së kërkesës pranë ministrit, duke përbërë një tejkalim të kompetencave, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
 - Neni 4/1 i ligjit referohet veçanërisht te “territori i bashkisë apo pjesa malore e atij territori”, ndërsa udhëzimi lë të hapur mundësinë që zona e zhvillimit të jetë çdo pjesë e territorit të bashkisë;
 - Pika 5 e udhëzimit duhet të përcaktojë qartë se grupi i punës duhet të ketë në përbërje një përfaqësues nga sektori i punëve publike dhe një përfaqësues nga njësitë administrative;
 - Pika 6 e udhëzimit kërkon riformulim. Verifikimi i statusit juridik të një prone realizohet vetëm përmes aplikimeve pranë ASHK-së. Njësitë Administrative nuk e kanë këtë kompetencë;
 - Neni 7 i udhëzimit, shkronjat “a” dhe “b”, devijojnë procedurën standarde që ndiqet për propozimin e projektakteve në këshill bashkiak dhe duhet qartësuar nëse është e nevojshme që ky material, tashmë i konkluduar dhe i nënshkruar nga grupi i punës, të kalojë për konfirmim nga DJ, DPPZHT etj;
 - Të sqarohet procedura që duhet ndjekur në rastet kur “zona e zhvillimit” ndodhet brenda një Zone të Mbrojtur, duke pasur parasysh që Zonat e Mbrojtura kanë një administrim dhe pronësi të ndryshme nga ajo e bashkisë dhe janë pronë shtetërore;
 - Të përcaktohet procedura “për identifikimin e zonës së zhvillimit”, (neni 4, pika 4 e ligjit 20/2025), gjithashtu të specifikohet procedura për” poseduesin jo pronar”; kjo vërehet në pike 4a, pika ç dhe pika 8 e si dhe pika 11 c;
 - Të shënohet prania e poseduesve dhe sipërfaqja e posedimit të hiqet në përputhje me kërkesat e ligjit, i cili parashikon vetëm “praninë e poseduesve” kudo ku është shënuar numri i poseduesve.
2. Për **projektligjin “Për gjuetinë”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në mbledhjen e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Neni 6, pika 2 të specifikohet se vlerësimi biologjik dhe përgatitja e informacionit për gjuetinë reduktuese duhet të kryhen nga aktorë të specializuar, dhe jo t’i ngarkohen NJVV-ve;
 - Të përcaktohet qartë në ligj që hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Faunës duhet të realizohet nga institucione të licencuara, me përfshirjen e bashkive përmes marrëveshjeve të formalizuara bashkëpunimi;
 - Neni 11, pika 1, zonat e gjuetisë dhe kufijtë e tyre të caktohen në bashkëpunim me AKZM, bazuar në udhëzime të detajuara teknike dhe financiare;
 - Neni 12, procedura për heqjen apo rishikimin e statusit të një zone gjuetie kërkon mbështetje teknike dhe financiare;
 - Neni 17, pika 2, shpallja e rezervateve të mëkëmbjes të ushtrohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Faunës në bashkëpunim me AKZM dhe aktorë të tjerë teknikë, përfshirë bashkitë;
 - Në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RVN), fq6, të rishikohet vlerësimi financiar, si dhe përfshirja e parashikimeve për mbështetje buxhetore dhe forcimi i kapaciteteve për NJVV-të;

- Projektligji duhet të përmbajë një strukturë të qartë bashkëpunimi ndërmjet NJVV-ve, AKZM, institucioneve kërkimore dhe organizatave partnere.
3. Për projektvendimin “Për miratimin e dokumentit politik të moshimit dhe planit të veprimit 2025-2030”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në mbledhjen e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.

Z. Arbjan MAZNIKU
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor



Z. Aldrin DALIPI
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

